



VENDIMI dhe GJETJET

Data e miratimit: 30 shtator 2013

Nr. i lëndës: 2012-19 & 2012-20

H & G

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut përmes mjeteve elektronike në përputhje me rregullën 13 të rregullores së vet të punës më 30 shtator 2013 me anëtarët e paraqitur si në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit, siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesat janë regjistruar në Panel më 19 nëntor 2012.
2. Më 22 dhe 24 janar 2013 përfaqësuesi i ankuesve ka ofruar informata shtesë në Panel.

3. Për shkak të shqetësimeve që lidhen me sigurinë tyre, Paneli ka miratuar kërkesën e ankuesve që emrat e tyre mos të zbulohen.
4. Më 11 prill 2013, Paneli ka komunikuar ankesat e H dhe G në grup, pa paragjykuar mundësinë që më vonë të urdhërohet bashkimi formal i këtyre lëndëve, në përputhje me rregullën 20 të rregullores së vet të punës.
5. Vërejtjet e shefit të misionit (ShM) janë pranuar më 10 qershor 2013, të cilat pastaj ju ishin komunikuar ankuesve për vërejtje të mëtejshme. Ankuesit nuk ka bërë ndonjë parashtresë shtesë.
6. Duke marrë parasysh shkallë sa janë të ngjashme çështjet e ngritura në të dyja ankesat, me anë të kësaj Paneli ka urdhëruar bashkimin formal të këtyre dy rasteve (H dhe G), në pajtim me rregullën 20 të rregullores së vet të punës.

II. FAKTET

Rrethanat e rastit

Faktet e mëposhtme janë vërtetuar në bazë të informatave që i kanë ofruar ankuesit:

Ankuesi H

7. Më 28 qershor 2012, ankuesi H ka vizituar Kosovën si pjesë e një delegacioni zyrtar të "veteranëve serb" për të vendosur kurora në një monument në *Gazimestan*. Këtij delegacionit ju ishte lejuar të kaloj dhe ata kishin arritur në monumentin në *Gazimestan* "*bashkë me të gjitha shenjat që kemi pasur në këmishat dhe këmishat pa mëngë tonat, siç janë emblemat e veteranëve serb dhe kurorat të cilat i kemi vendosur në monument*".
8. Duke u kthyer nga *Gazimestani*, rreth orës 14:00, në pikën kufitare në Merdare, e ashtuquajtura Njësia Rajonale Operative Mbështetëse (NJMRO) dhe Policia e Kosovës (PK) kanë ndaluar automjetin në të cilin ankuesi ishte duke udhëtuar së bashku me një koleg dhe një vozitës.
9. Ankuesit dhe dy individëve të tjerë që po udhëtonin me të ju ishte thënë që të dilnin prej automjetit. Ankuesi thotë se ishte pyetur në lidhje me shenjën e "veteranëve serbë" që ishte e dukshme në anën e majtë të xhepit të këmishës së tij. Ankuesi më tej thotë se gjatë asaj kohe një ekip i TV stacionit vendor të Kosovës "KTV" ishte i pranishëm dhe po filmonte pamjen.
10. NJMRO-ja dhe PK-ja [ankuesi supozon se PK-ja i takonte policisë kufitare] kontrolluan automjetin dhe valixhet e tyre. Sipas ankuesit "*ata*

kanë marrë nga bagazhi i automjetit një flamur të veteranëve serb dhe e kanë treguar atë para kamerave".

11. Pastaj, në bazë të një urdhri të lëshuar nga një komandant i PK-së/NJMRO-së, ankuesi dhe kolegu i tij ishin dërguar në *"kontejnerin e fundit [të policisë] në anën e majtë, në drejtimin që çon drejt Serbisë"*.
12. Brenda kontejnerit, një zyrtar i policisë i ka thënë ankuesit ta zhveshte këmishën e tij [e cila mbante një simbol serb] duke ju kërcënuar se përndryshe zyrtari i policisë do t'ia shqyente atë. Ankuesi deklaroi se kishte ndjenjën se ky zyrtar dëshironte të niste grindje, kështu që ai ju kishte bindur dhe kishte zhveshur këmishën.
13. Është pohuar se një tjetër zyrtar policor e ka hapur derën e kontejnerit dhe e ka pyetur zyrtarin brenda në qoftë se ai tashmë e kishte filluar rrahjen, dhe nëse ai në këtë drejtim do të kishte nevojë për ndonjë ndihmë.
14. Më tej pohohet se pas një kohë, një njeri me një këmishë të bardhë [me sa duket ishte zyrtar i lartë sipas ankuesit] urdhëroi ankuesin të lëviz në një tjetër kontejner, që ankuesi beson se ishte përdorur si hapësirë për zyre.
15. Është pohuar se pastaj ky zyrtar i lartë hoqi pantallonat e tij për të treguar një mavijosje të madhe në kofshën e tij, të cilën gjoja e kishte marrë gjatë atij mëngjesi në të njëjtën pikë kufitare. Është pohuar se duke bërë kështu ky zyrtar i policisë kishte për qëllim të provokonte ankuesin dhe për të zbuluar nëse ankuesi dhe shoqëruesit e tij ishin në dijeni të ngjarjeve të atij mëngjesi, që lidheshin me një incident të dhunshëm që ankuesi nuk ishte në dijeni.
16. Një person tjetër në rroba civile, i cili mbante një revole u shfaq pastaj dhe i mori disa nga gjërat e tyre. Është pohuar se disa nga këto gjërat ishin konfiskuar, në veçanti gjërat që kishin emblemat e veteranëve serb në to. Pastaj zyrtari i policisë ndezi TV-në dhe tha: *"Je bërë i famshëm tani, po ju transmetojnë drejtpërsëdrejti në TV"*. Gjoja se në titrat në programin televiziv shkruante: *"Drejtpërsëdrejti nga Merdare, nacionalistët serbë janë ndaluar në Merdare"*.
17. Është deklaruar se ankuesi ishte provokuar disa herë nga PK-ja atëherë kur ata kanë pyetur nëse kishte filluar rrahja. Një njeri tjetër me rroba civile supozohet se ka deklaruar se ankuesi dhe shoqëruesit e tij do të mbahen në paraburgim për një muaj. Kur ankuesi kishte pyetur se për çfarë arsye, atij ju ishte thënë se ata kishin shkelur ligjet e Republikës së Kosovës.
18. Rreth orës 16:30, ankuesi dhe shoqëruesit e tij ishin urdhëruar të vazhdonin udhëtimin e tyre. Ankuesi ka deklaruar se gjatë gjithë kësaj kohe askush nga personeli i EULEX-it *"as që ishte dukur e leje më i pranishëm aty"*.

19. Ankuesi ka paraqitur një certifikatë për konfiskimin e përkohshëm të gjërave. Nuk dihet nëse ankuesit ju kanë kthyer gjërat e veta.

Ankuesi G

20. Më 28 qershor 2012, ankuesi së bashku me një grup miqsh kanë shkuar në Kosovë për të vënë kurora në monumentin në *Gazimestan*. Ky grup kishte arritur në vendkalimin kufitar në Merdare rreth orës 06:20. Grupi kishte vendosur ta linte automjetin dhe ta kalonte kufirin në këmbë.
21. Supozohet se derisa ishin duke qëndruar në radhë duke pritur që të kontrolloheshin dokumentet e tyre, një zyrtar i PK-ja ju ishte afruar grupit dhe ju ishte drejtuar atyre në gjuhën shqipe. Një prej shokëve të ankuesit gjoja se ka pyetur zyrtarin e policisë që tu shpjegoj atyre se për çfarë ishte duke folur ai, pasi asnjëri nga grupi prej 12 personave nuk ishin në gjendje të flisnin shqip. Supozohet se zyrtari i policisë e kishte tërhequr personin e parë nga rreshti dhe e kishte pyetur në mënyrë të vrazhdë "*Çfarë po bën ti këtu?*" në gjuhën serbe.
22. Ky person ju kishte përgjigjur se grupi ishte në një pelegrinazh dhe se ata kanë për qëllim të vënë kurorë në monumentin në *Gazimestan*. Është pohuar se zyrtari i PK-së i kishte bërë titull grupit në gjuhën shqipe, dhe pastaj ju kishte thënë: "*Çfarë po bën këtu, kjo nuk është më toka juaj*". Është pohuar se zyrtari i policisë kishte vënë re se ankuesi dhe disa nga shokët e tij kishin të veshur bluza me mëngë të shkurta me emblema serbe.
23. Ankuesi ka deklaruar se në mënyrë që të mos provokojë askënd, ai e kishte veshur një xhakëtë mbi këmbishën e tij pa mëngë. Megjithatë PK-ja e kishte vënë re këmbishën e tij pa mëngë dhe supozohet se një zyrtar i kishte bërë titull ankuesit dhe e kishte tërhequr atë për mënge, duke i kërkuar atij që ta zhveshte atë. Ankuesi ju kishte bindur urdhrin. Pas kësaj, ankuesi ishte dërguar në një kontejner, ku ishte kontrolluar ai dhe çanta e tij.
24. Ankuesi thekson se ai ishte ndier i kërcënuar gjatë gjithë kohës. Sipas rrëfimit të tij, i gjithë grupi prej 12 personash ishte dërguar në të njëjtën kontejner për t'u kontrolluar. Kur ankuesi ishte kontrolluar, supozohet se kanë qenë të pranishëm katër zyrtarë të PK-së. Kur po e kontrollonin çantën e shpinës së ankuesit, PK-ja kishte gjetur një flamur serb. Është pohuar se PK-ja i kishte hedhur gjësendet e ankuesit në tokë dhe se njëri nga pjesëtarët e PK-së ishte ndalur dhe kishte pështyrë mbi to.
25. Ankuesi pretendon se "*i njëjti person, i cili po qëndronte në këmbë dhe po pështynte mbi gjësendet e mija më tha në gjuhën serbe si në vijim: "Unë do të pshurr mbi këto gjëra e pastaj do t'ju kthej ato", në të njëjtën kohë ai po qeshej*". Ankuesi së bashku me 11 persona të tjerë ishin mbajtur në kontejner për rreth 40 minuta. Pretendohet se të gjithë ata ishin kontrolluar dhe ishin trajtuar në të njëjtën mënyrë sikurse ankuesi.

26. Ankuesi më tutje thekson se posaçërisht ai ishte trajtue në mënyrë të ashpër dhe të vrazhdë nga një pjesëtar i PK-së, i cili e kishte sharë atë për shkak të kombësisë së tij. Kjo polic supozohet se e kishte shtyrë ankuesin jashtë kontejnerit, dhe kishte shkëlmuar në kofshën e majtë të tij. Pas kësaj, zyrtari i policisë ju kishte thënë të gjithëve të prisnin jashtë, me përjashtim të një të mituri, të cilin ai e mbajti brenda në kontejner. Pas rreth 10 minutash, i mituri doli nga kontejneri me "shenja të kuqe", të cilat ishin të dukshme në fytyrën e tij. Kur ankuesi e ka pyetur se çfarë kishte ndodhur, ai nuk ka thënë asgjë pasi *"ai dëshironte që vetëm të ecte më tutje, mos të shkaktonte telashe të tjera, edhe pse nga fytyra e tij mund të shihej se ata kishin përdorur dhunë"*.
27. Pastaj një zyrtar i PK-së kishte ardhur dhe urdhëruar grupin të presin që të marrin certifikatat për gjësendet e konfiskuara. Atëherë kur ai zyrtar i policisë shkoi përsëri në kontejner, supozohet se një tjetër zyrtar doli nga kontejneri, ku grupi po merrej në pyetje, dhe i ka thënë grupit se *"ai kishte urinuar mbi gjërat tona dhe në qoftë se duam mund të shkojnë brenda dhe t'i marrim ato, ne mund të marrim vetëm ujin dhe ushqimin që ishte konfiskuar, mirëpo jo gjërat personale (bluzat pa mëngë dhe flamujt)"*.
28. Është pohuar se pas pak minutash njëri prej zyrtarëve të policisë doli me certifikatat e konfiskimit. Ankuesi ka deklaruar se certifikata që ju ishte dorëzuar nuk ishte e saktë, si për shembull një kapelë që ishte konfiskuar nuk kishte pasur ndonjë shenjë serbe ashtu siç ishte shënuar në atë deklaratë. Ankuesi ju kishte kundërvënë atij zyrtari policor. Ky i fundit supozohet se kishte tërhequr armën dhe i kishte thënë ankuesit se kanë *"leje ta përdorin atë dhe më tha të zhdukem sa më shpejt që është e mundur"*.
29. Pas kësaj, grupi kishte kaluar pikën e kalimit kufitar dhe kishte vazhduar në drejtim të *Gazimestanit*. I mituri me shenja të skuqura në fytyrën e tij i ka thënë ankuesit se ai kishte qenë i ngacmuar në kontejner, ku PK-ja kishte përdorur forcë të panevojshme kundër tij, se ata e kishin goditur atë në fytyrë, e kishin goditur atë në stomak me grushta, dhe se gjithashtu njëri nga PK-ja e kishte shkëlmuar atë në kokë.
30. Ankuesi pohon se *"gjatë gjithë kësaj kohe kanë munguar zyrtarët e EULEX-it. Për shkak të sjelljes së pjesëtarëve të PK-së dhe qëndrimit të tyre ndaj nesh, ne nuk kemi qenë në gjendje të kontaktojmë EULEX-in"*.
31. Pasi kishin arritur në Graçanicë, rasti ishte raportuar në polici dhe EULEX. EULEX-i ju ka kërkuar ankuesve të dorëzonin certifikatat për gjërat e konfiskuara, të cilat i kanë dorëzuar. Deri më tani, ankuesi nuk ka marrë përgjigje nga EULEX-i.

Faktet përkatëse lidhur me përpjekjet për hetime të EULEX-it

32. Në vërejtjet e tij të datës 10 qershor 2013, EULEX-i ka pohuar se nuk është në dijeni rreth ndonjë hetimi të këtyre ngjarjeve të caktuara nga

ana e PK-së. Për më tepër EULEX-i ka pohuar se nuk ka zhvilluar ndonjë hetim rreth këtyre ngjarjeve.

33. Sa i përket ankuesit G, EULEX-i ka pohuar se hetimet e bëra nga EULEX-i nuk kanë çuar drejt ndonjë dëshmie të pranimit të një ankese ose të dorëzimit të certifikatave për gjësendet e konfiskuara.

EULEX-i si reagues i dytë

34. Më tej EULEX-i ka pohuar se roli i tij kryesor në lidhje me Policinë Ekzekutive ishte që të bëhej gati si reagues i dytë, aty ku kërkohej për të reaguar nga PK-ja.

LIGJI PËRKATËS NË FUQI

Veprimi i përbashkët

35. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të zbatuar instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. E një rëndësie të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Konventa Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat në shumë aspekte ofrojnë standardet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet demokratike ligjore.

Veprimi i përbashkët

36. Pjesët përkatëse të shkëputura të nenit 2 dhe 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit Evropian 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i në KOSOVË (më tutje: Veprimi i përbashkët), thotë si më poshtë:

Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i KOSOVË do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies, dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumë-etnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe përfillin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane.

EULEX-i KOSOVË në bashkëpunim të plotë me Programin për Ndihmë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke ruajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

Neni 3 Detyrat

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në Nenin 2, EULEX-i në Kosovë do të:

- (a) monitoron, udhëzon dhe këshillon institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit (përfshirë shërbimin doganor), përderisa i ruan disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive;
- (b) siguron mbajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik duke përfshirë sigurinë, kur është e nevojshme, në konsultim me autoritetet civile ndërkombëtare në Kosovë, duke ndryshuar apo anuluar vendime operationale të marra nga autoritetet kompetente të Kosovës;
- (d) siguron që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ndëretnik, krimit financiar/ekonomik dhe krimeve tjera të rënda të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe zbatohen siç duhet, sipas ligjit në fuqi, përfshirë, kur është e përshtatshme, nga hetues, prokurorë dhe gjykatës ndërkombëtarë së bashku me hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit e Kosovës ose në mënyrë të pavarur, dhe përmes masave duke përfshirë, nëse ka nevojë, krijimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të strukturave ndërmjet autoriteteve policore dhe të prokurorisë;
- (h) merr përgjegjësi tjera, në mënyrë të pavarur apo me përkrahje të autoriteteve kompetente të Kosovës, për të siguruar mbajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik dhe sigurisë, në konsultim me agjencionet përkatëse të Këshillit; dhe
- (i) siguron që të gjitha aktivitetet e tij i përfillin standardet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut dhe çështjet gjinore.”

Ligji mbi kompetencat

Neni 17

17.1 Gjatë kohëzgjatjes së EULEX-it KOSOVË në Kosovë, policia e EULEX-it do të ketë kompetencë që të ushtroj autorizimet e vet ashtu siç njihen me anë të ligjit në fuqi për policinë Kosovës dhe në përputhje me modalitetet e përcaktuara nga shefi i EULEX-it KOSOVË.

III. ANKESAT

- 37. Ankesat kanë të bëjnë me dy incidentet në pikën kufitare Merdare, të cilat lidhen me festimet e Vidovdanit më 28 qershor 2012.
- 38. Ankuesit mbështeten në një numër të të drejtave të mbrojtura, duke përfshirë të drejtën për të mos ju nënshtruar trajtimit mizor, çnjerezor ose poshtërues (p.sh. neni 3 i KEDNJ; Neni 7 KNDCP), të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 i KEDNJ; Nenet 17/23 KNDCP), e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (Neni 9 KEDNJ; Nenet 18/19 KDDCP), liria e shprehjes (neni 10 KEDNJ; Neni 19 KNDCP), të drejtën e lirisë së tubimit dhe e organizimit (Neni 11 KEDNJ, Neni 21/22 KNDCP), e drejta për ankim efektiv (neni 13 KEDNJ; Neni 2

KNDCP), si dhe ndalimi i diskriminimit (neni 14 KEDNJ, Neni 26/27 KNDCP). Ata pohojnë se të drejtat e tyre janë shkelur si rezultat i fakteve ndaj të cilave bërë ankesë.

IV.LIGJI

39. I mbetet Panelit për të përcaktuar karakterizimin ligjor të ankesave që do të shqyrtohen. Paneli do të shqyrtojë të dy rastet, sipas dispozitave në vijim: e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 KEDNJ; Neni 17 KNDCP); të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (Neni 9 KEDNJ; Nenet 18 dhe 19 KNDCP); të drejtën e lirisë së tubimit dhe shoqërimit (neni 11 KEDNJ; Nenet 21 dhe 22 KNDCP) dhe e drejta për një ankim efektiv (neni 13 KEDNJ; Neni 2 KNDCP).
40. Paneli përsërit qasjen që ka miratuar në vendimin e vet A, B, C dhe D kundër EULEX-it (Lënda Nr. 2012-09, 2012-10, 2012-11 dhe 2012-12) të datës 20 qershor 2013. Sikur që kjo lëndë ka të bëjë, sikurse me ato, me festimet e Vidovdanit më 28 qershor 2012, këtu janë të zbatueshme gjetjet e mëhershme të Panelit në lidhje me planifikimin dhe kontrollin e operacioneve të EULEX-it në kontekst të këtyre ngjarjeve. Prandaj, Paneli i referohet dhe miraton me referencë të gjeturat dhe konkluzionet e veta siç janë të përfshira në vendimin A, B, C dhe D, në paragrafët 45-49, në masën sa ato janë relevante me këtë vendim.

Përgjegjësia e EULEX-it për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

41. Paneli pranon se duke pasur parasysh mandatin e kufizuar ekzekutiv të EULEX-it, ai nuk mund të mbahet përgjegjës për mos garantimin e një mbrojtje efektive të të drejtave të njeriut si e tillë në Kosovë dhe sa i përket punës së policisë, ajo është një barrë e pamundur ose disproporcionale që nuk mund t'i ngarkohet Misionit.
42. Megjithatë Paneli vëren se është obligim i EULEX-it nën Veprimin e Përbashkët të Këshillit për të siguruar që aktivitetet e tij duhet të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (shih Nenin 3 (i), Këshilli i Përbashkët i Veprimit 2008/124/CFSP, shih paragrafin 36 më sipër). Për këtë arsye kërkohet që EULEX-i të ndërhyjë për të mbrojtur të drejtat e njeriut kudo që i di ose duhet të ketë njohur në kohën e një rrezik real dhe të menjëhershëm se shkelja mund të ndodhë në qoftë se nuk do të ndërhyrë (shih, p.sh. *Gjorgjeviq kundër Kroacisë*, nr. 41526/10, § 138-139, KEDNj 2012 dhe referencat e cituara aty; *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 28 tetor 1998, § 16). Natyra e përgjigjes duhet të jetë e përshtatshme për rrethanat dhe nga ana tjetër, varet se cila e drejtë apo të drejta ishin vënë në rrezik si dhe në seriozitetin e kërcënimeve ndaj këtyre të drejtave (shih vendimin e Panelit në *Kahrs kundër EULEX-it*, nr.2012-16 , § 31).
43. Rrjedhimisht, Paneli do të shqyrtojë nëse, në rastin konkret, veprimet ose mosveprimet e EULEX-it, për aq sa ato kanë prekur ankuesit në

kontekstin e operacionit policor më 28 qershor 2012, ishin në përputhje me detyrimet e të drejtave të njeriut të EULEX-it që dalin në lidhje me ushtrimin e mandatit ekzekutiv të EULEX siç përcaktohet më sipër.

44. Si çështje paraprake, Paneli konstaton se EULEX-i nuk pritet të ofrojë forca policore më mirë sesa do të lejonin burimet e vëna në dispozicion. Megjithatë, EULEX-i është i obliguar që të ndërmerri masat e nevojshme dhe të arsyeshme në kuadër të kompetencave të tij për të siguruar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të atyre që gjenden në territorin e Kosovës.
45. Ky është po ashtu rasti ku, si në rastin në fjalë, sjellja e PK-së paraqet një rrezik real se këto të drejta mund të shkelen. Në një rast të tillë, EULEX pritet të ofrojë mbrojtje - duke përfshirë edhe ato operative - të afta për të siguruar që PK-ja të veprojë në përputhje me detyrimet e tij dhe kur ata nuk veprojnë ashtu dhe vënë ushtrimin efektiv të këtyre të drejtave në rrezik, të ndërhyjë në mënyrë të përshtatshme për të parandaluar çfarëdo shkelje, dhe nëse kjo duhet të jetë e nevojshme për këtë qëllim, madje edhe nëse duhet të ndryshoj ose anuloj vendimet operacionale të PK-së në përputhje me nenin 3b) të Veprim të Përbashkët.
46. Paneli konstaton se duke marrë pjesë në festimet në Gazimestan, ankuesit kanë kërkuar të ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e tubimit dhe të drejtën e tyre për lirinë e ndërgjegjes. Përderisa ata nuk ishin të penguar nga pjesëmarrja, ata ju ishin nënshtruar trajtimit të papërshtatshme në pikën kufitare Merdare, e cila negativisht i ka prekur ato të drejta. Ankuesit ishin të frikësuar dhe të provokuar nga PK-ja.
47. Nuk është treguar apo argumentuar se policia e EULEX-it ka qenë dëshmitare e incidenti, për të cilën ka pasur ankesë, apo se ata ishin të pranishëm në kontejnerë, aty ku ankuesit u sollën. Pra nuk është vërtetuar në bazë të materialit para Panelit se EULEX-i ka qenë drejtpërdrejt përgjegjës për ndonjë dështim për të trajtuar ose për të parandaluar incidentin në fjalë. Megjithatë mungesa e largpamësisë së nevojshme në lidhje me planifikimin e festimeve të përvitshme të Vidovdanit, dhe si rezultat mungesa e numrit të mjaftueshëm të policëve të EULEX-it në vendngjarje krijon shqetësim.
48. Paneli konstaton mungesën e dokumentacionit të hollësishëm operacional dhe planifikimit për raste të paparashikuara. Mund të ishte parashikuar nga EULEX-i që pika hyrëse e Merdares, si një nga pikat kryesore të kalimit kufitar, do të përdorej nga një numër i madh i pjesëmarrësve për festimet e Vidovdanit gjatë hyrjes në Kosovë.
49. EULEX-i ka ofruar informacione për Panelin rreth përplasjes së dhunshme mes PK-së dhe pjesëmarrësve në festimet e Vidovdanit nga Serbia në pikën e kalimit Merdare në ditën e rëndësishme rreth orës 07:30, duke përfshirë dhjetëra njerëz e duke rezultuar deri në 32 zyrtarë policorë të PK-së dhe një numër i panjohur i civilëve të plagosur. Ky

incident ka treguar se pikat kufitare nuk ishin të siguruar siç duhej dhe se dhuna kishte të ngjarë të ndodhte në këtë rast më vonë gjatë ditës.

50. Ky incident duhej të kishte alarmuar EULEX-in për faktin se pikat e kalimit nuk ishin të siguruar siç duhej në atë ditë dhe se dhuna kishte të ngjarë të ndodhte në këto vende. Mungesa e një numri të duhur të zyrtarëve të EULEX-it në pikën kufitare Merdare, pas atij incidenti demonstroi mungesën e largpamësisë nga ana e EULEX-it. Rritja e numrit të zyrtarëve të EULEX-it do të kishin kontribuar në pengimin e çdo lloji sjelljeje nga ana e PK-së që të mund të përbënte shkelje të mundshme të të drejtave të njeriut. Ajo gjithashtu mund t'i kishte mundësuar zyrtarëve të EULEX-it në vendngjarje të ndërhyjnë për të ndaluar apo parandaluar çdo shkelje të të drejtave të njeriut për të cilat ata kanë qenë dëshmitar. Nuk është treguar se kjo do të kishte qenë tepër vështirë për t'u bërë nga ana e EULEX-it.
51. EULEX-i ka dhënë shifra kundërtëdhënëse lidhur me numrin e zyrtarëve të EULEX-it të cilët ishin në detyrë gjatë ngjarjeve të Vidovdanit dhe në lidhje me vendndodhjen e tyre të saktë. Sipas informatave në dispozicion të Panelit, vetëm dy policë të EULEX-it ishin të pranishëm në atë kohë në pikat e kalimit kufitar Merdare, duke kryer aktivitetet e tyre të MMK-së. Sipas mendimit të Panelit, është e qartë se ky numër ishte i pamjaftueshëm për t'u marrë me ngjarjet e Vidovdanit, madje edhe duke pasur parasysh burimet e kufizuara të EULEX-it. Mungesa e një numri të duhur të zyrtarëve të EULEX-it në pikën kufitare Merdare përkundër njohurisë së EULEX-it rreth rreziqeve që përfshiheshin tregon mungesë largpamësie nga ana e EULEX-it.
52. Fakt i padiskutueshëm se operacioni ishte udhëhequr nga PK-ja nuk liron EULEX-in nga përgjegjësia e vet për të siguruar se përfshirja e tij në këto ngjarje dhe operacione të ishte në përputhje me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut. Në veçanti, Panelit nuk ju është ofruar ndonjë informatë se janë ndërmarrë hapa të përshtatshëm për të siguruar bashkërendimin e duhur me PK-në në mënyrë që të sigurojë mbrojtje efektive të pjesëmarrësve kundër dhunës ose llojeve të tjera të shkeljeve të të drejtave të tyre, duke përfshirë masat parandaluese për të siguruar që veprimet e PK-së ishin në përputhje me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut. Në këtë aspekt, Paneli thekson se është e një rëndësie të veçantë që PK-ja të jetë e trajnuar dhe këshilluar siç duhet rreth standardeve të zbatueshme të të drejtave të njeriut lidhur me trajtimin e përgjithshëm të pjesëmarrësve në këtë lloj të ngjarjeve, si dhe rreth kushteve për konfiskimin e ligjshëm të pronës së tyre.
53. Paneli konkludon se si rezultat i burimeve të pamjaftueshme të caktuara në operacionin e Vidovdanit nga ana e EULEX-i me synimin për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut, trajnimit jo të duhur dhe udhëzimeve të pamjaftueshme operative, ankuesit G dhe H ju ishte mohuar gëzimi i plotë dhe efektiv i të drejtave të tyre për respektimin e jetës private, lirisë së tubimit, si dhe të drejtës për të ushtruar fenë e tyre në mënyrë të sigurt dhe pa pengesa të panevojshme.

Hapat hetimore

54. Paneli më tutje konstaton se bazuar në informatat që u janë ofruar Panelit, nuk janë ndërmarrë hapa hetues pas festimeve të Vidovdanit në qershor 2012 me qëllim të hetimit të shkeljeve të supozuara nga ankuesit.
55. Megjithatë Paneli konstaton se nuk ka asnjë tregues pranë Panelit se ndonjë autoritet i EULEX-it i ka ditur këto dy incidente apo se ato ishte sjellë ndonjëherë në vëmendje të EULEX-it.
56. Në këto rrethana, Paneli konstaton se dështimi i EULEX-it për të hetuar këto dy incidente nuk përbën shkelje të të drejtave të ankuesve, e cila mund t'i ngarkohet EULEX-it.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI,

1. *Konsideron* se ka pasur shkelje të neneve 8, 9 dhe 11 të KEDNj-së, si dhe të neneve 17, 18, 21 dhe 22 të KNDCP në lidhje me të dy ankuesit;
2. *Konstaton* të përshtatshme, që marrë parasysh gjetjet e mësipërme dhe deri në masën që ShM deri më tani nuk ka vepruar sipas rekomandimeve të Panelit në lëndët [2012-09 A.](#), [2012-10 B.](#), [2012-11 C.](#), [2012-12 D.](#), të bëjë rekomandimet e mëposhtme për ShM sipas rregullës 34 të rregullores së vet të punës:
 - i. Që ShM të pranon se të drejtat e ankuesve janë shkelur nga EULEX-i.
 - ii. Që ShM të kërkon nga të gjitha degët dhe organet përkatëse të EULEX-it, të cilët posedojnë informacione në lidhje me ngjarjet e Vidovdanit të vitit të kaluar, t'i sigurojnë një pasqyrë të plotë të veprimeve të EULEX-it gjatë këtyre ngjarjeve. Mbi këtë bazë, ShM të siguron që çdo informacion në posedim të EULEX-it lidhur me shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut të kryera në këtë kontekst (përfshirë çdo shkelje që i ngarkohet zyrtarëve të PK-së) t'ju ofrohet autoriteteve kompetente të Kosovës për veprime dhe hetime të mëtutjeshme. Nëse EULEX-i më vonë përcakton se rastet e tilla nuk ishin hetuar plotësisht dhe në mënyrë të duhur, EULEX-i të merr në konsiderim marrjen përsipër të përgjegjësisë së hetimit të këtyre rasteve.
 - iii. ShM ftohet të hulumton me autoritetet kompetente hetuese dhe prokuroriale në EULEX nëse mund të merren hapa hetimor në lidhje me incidentin që përfshihen ankuesit H dhe G.

Paneli fton ShM të njofton ankuesit drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve kompetente hetimore të EULEX-it rreth rezultatit të këtyre hetimeve. Ankuesit janë të lirë për të raportuar tek Paneli në lidhje me ndonjë çështje të pazgjidhur kur kontaktohen nga EULEX-i.

- iv. Nëse EULEX-i luan ndonjë rol në festimet e Vidovdanit në vitin 2014, ShM të siguron që autoritetet kompetente të EULEX-it:
 - a) të kryejnë një vlerësim të rrezikut me qëllim të krijimit dhe identifikimit të burimeve të mundshme të rreziqeve ndaj mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut të pjesëmarrësve në festimet e Vidovdanit. Për këtë qëllim, autoritetet kompetente të EULEX-it t'ju drejtohen dhe t'i mësojnë mësimet nga dobësitë e identifikuar gjatë operacionit të Vidovdanit në qershor të vitit 2012 dhe siç janë regjistruar në vendimin e tanishëm;
 - b) të paraqesin tek ShM një plan të hollësishëm në lidhje me përfshirjen e EULEX-it në festimet e ardhshme të Vidovdanit më 28 qershor 2014. Një plan i tillë të përfshijë një përshkrim të hollësishëm të mjeteve dhe burimeve të nevojshme për të siguruar që zyrtarët e EULEX-it të kryejnë përgjegjësitë ekzekutive në mandatin e tyre në mënyrë efektive, në veçanti në lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave të njeriut të pjesëmarrësve në këto ngjarje. Kjo do të përfshijë, nëse është e nevojshme, mundësinë që zyrtarët e EULEX-it të thërrasin përforcime. Kjo planifikon që gjithashtu të përfshihen mjete të duhura të komunikimit dhe transportit për të siguruar se është e mundur ndërhyrja e shpejtë kur është e nevojshme me qëllim të parandalimit apo të dhënies fund të shkeljeve të të drejtave të njeriut;
 - c) të sigurojnë bashkërendim të duhur ndërmjet Misionit të EULEX-it në njërën anë dhe PK-së dhe autoriteteve kompetente të Kosovës në anën tjetër, në mënyrë që të ketë mbrojtje efektive të pjesëmarrësve gjatë këtyre festimeve. Gjithashtu EULEX-i të siguron që zyrtarët e PK-së të përfshirë në rastet e tilla të jenë plotësisht të vetëdijshëm se kryerja e dhunës mbi pjesëmarrësit nuk do të tolerohet dhe se do të vendosen mekanizmat e përgjegjësive për të ndëshkuar keqbërësit;
 - d) në përputhje me burimet që janë për qëllime të tilla në mënyrë të arsyeshme në dispozicion, të caktojnë për këtë detyrë një numër të mjaftueshëm të zyrtarëve të EULEX-it, në proporcion me rëndësinë e këtyre ngjarjeve të Vidovdanit dhe në përputhje me

- rrezikun potencial të shkeljeve të të drejtave të njeriut;
- e) të ofrojnë udhëzime dhe urdhra të qarta për të gjithë zyrtarët e policisë së EULEX-it të përfshirë në këtë operacion, posaçërisht në lidhje me rrethanat në të cilat ata mund të jenë të detyruar të ndërhyjnë për të mbrojtur të drejtat e njeriut të pjesëmarrësve.
- v. Lidhur me hetimin dhe raportimin e mundshëm për sjellje të pahijshme, ShM po ashtu të siguron që zyrtarët e EULEX-it të përfshirë në operacionin e Vidovdanit të regjistrojnë me kujdes secilin rast të shkeljeve të të drejtave të njeriut që mund ta shohin apo që mund t'ju raportohet atyre. EULEX-i nga ana tjetër të heton secilin prej këtyre incidenteve të dyshuara dhe/ose ta transmetojnë këtë informacion tek autoritetet kompetente hetimore të Kosovës me qëllim që të sigurohet hetim efektiv i çfarëdo rasti të tillë.

Ftohet ShM që të njofton Panelin rreth masave që i ka ndërmarrë në lidhje me këtë vendim më së largu deri më datën 5 nëntor 2013.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda Mierzevska
Kryesuese